



**AKT THEMELIMI & STATUT**

**I SHOQERISE "ACTIVE" shpk, TIRANE**

Sot me date 08 Qershor 2020 (dymije e njezet), para meje Noter Muli Y. MALLKUÇI, Anetar i Deges Vendore Notereve Tirane, me Zyre ne Rr. "Vaso Pasha", Pall. 13/1, u paraqit personalisht:

**Z. Edmir DURAKU**, lindur me 22,11,1986 ne Kukes ,banues ne Tirane , madhor,me zotësi juridike dhe për të vepruar me dokument identifikues I 61122033N

E cila me cilesine e " Ortakut Themelues ", me kerkoi redaktimin e ketij Akti Themelimi & Statut, nepermjet te cilit deklaroi se, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ne Ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, "**ACTIVE** " shpk, Tirane.

Neni 1  
Krijimi

Shoqeria "**ACTIVE shpk** , Tirane, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**ACTIVE** " shpk , Tirane, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3  
Selia

Shoqeria e ka seline ne:Bulevardi Deshmoret e Kombit , Kullat Binjake , Nr.1 , kati 8 , Zona Kadastrale Nr. 8270 , Nr pasurie 3/239 +1 -N33 ; Vol 28, faqe 252 , Njesia Bashkiake Nr 5 , kodi postar 1019 .

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqëria "ACTIVE" shpk do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar ne fushen sportive, duke vene ne dispozicion te individeve te ndryshem fushat e mbuluara per te luajtur, futboll, basketboll, volejball. kalceto, si dhe te tjera aktivitete sportive, bar-resorant, lojra te ndryshme per femije etj etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR).

Neni 6

Kapitali themeltar

**Kapitali themeltar** i shoqerise eshte 1.000Lekë dhe eshte i ndare në 1 (kuote) pjesë të barabarta, vlera nominale e të ciles eshte 1.000Lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i vetem i shoqerise, **Z. Edmir DURAKU**, i cili zoteron 1 (nje) te kuote, me vlere te pergjithshme 1.000Leke, qe perbejne 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Ortakut te Vetem të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 5 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit



Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut të Vetem.  
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 9

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Ortaku i Vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët,

Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person.

Neni 10

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaku i vetem.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11

Administrimi

**Administrator** i shoqerise do te jete **Z. Edmir DURAKU**, per nje afat prej 5 vjetesh.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 12

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti I administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.


Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 13

Pergjegjessite

Administratori eshte pergjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të



shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortaku i vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Ortaku ka të drejtë të ndjeke në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaku që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

#### Neni 14

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 15

##### Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### Neni 16

##### Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar per gatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaku i vetem, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

#### Neni 18

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqërisë.

#### Neni 19



Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

#### Neni 20

##### Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku i vetem i shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj të shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

#### Neni 21

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar ne QKR.

#### Neni 22

Likuidatori eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

#### Neni 23

##### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacioneve shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit per QKR, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

#### Neni 24

##### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij

statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25  
Rregjistrimi

Rregjistrimin e shoqerise prane QKB, (QKR), do ta beje **Zj. Fatime GJONI**, lindur me 04.09.1961, me leternjoftim nr.personal G15904083G.

Neni 26  
Dispozita perfundimtare

Ky Akt Noterial, u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare " **ACTIVE** " shpk, Tirane, nenshkruhet rregullisht para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

ORTAKU I VETEM

**Edmir DURAKU**

*Edmir Duraku*  


NOTER

Muli Y. MALLKUÇI